

PROCESVERBAL
nga seanca e 11-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 20.03.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski hapi seancën e 11-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:35 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 6-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 14.03.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 10-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 14.03.2024.
3. Draft-raporti vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023.
4. Draft-udhëzim për transmetuesit për zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024.
5. Raporti i parë nga monitorimi i periudhës parazgjedhore - nga 15 shkurt deri më 7 mars 2024.
6. Të ndryshme.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar nga Seanca e 6- të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 14.03.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar nga seanca e 10-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 14.03.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Draft-raportin vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023. Ai ka shpjeguar se përgatitja e këtij Raporti paraqet detyrim ligjor për Agjencinë dhe deri më 31 mars të vitit aktual duhet të dorëzohet në Kuvendin e RMV-së. Ai përmban të gjitha aktivitetet e realizuara të Agjencisë nga viti i kaluar, përkatësisht, përmban Raport për realizimin e mbikëqyrjeve si dhe Raportin Financiar për realizimin e planit financiar për vitin 2023. Një nga aktivitetet e rëndësishme vitin e kaluar ishte reformimi i legjislacionit mediatik, ndryshimi i LSHMAAV, ku Agjencia mori pjesë në bashkëpunim me përfaqësues ekspertë të BE-së. Ndryshime janë bërë në ligj në korrik 2023. Duhet të vazhdojë dhe faza e dytë në drejtim të rekomandimeve të ekspertëve të BE-së, por fatkeqësisht nuk ka ndodhur dhe ky proces me siguri do të vazhdojë pas zgjedhjeve. Agjencia gjithashtu ishte përfshirë në grupin e punës për ndryshimet në Kodin Zgjedhor dhe menaxhonte nëngrupin e medias. Tekst i harmonizuar i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor është dërguar në Kuvend, por fatkeqësisht deri më tani nuk është shqyrtuar. Duke qenë se Kuvendi brenda një kohe të shkurtër do të shpërndahet, pritet që ndryshimet në Kodin Zgjedhor të shqyrtohen në përbërjen e ardhshme të Kuvendit. Agjencia gjithashtu mori pjesë në disa takime dypalëshe me Komisionin Evropian për kapituj të ndryshëm. Vitin e kaluar, edhe pse nuk kishin detyrim ligjor, është hartuar Plani Strategjik i Agjencisë 2024-2028 për periudhë pesëvjeçare, në të cilin përcaktohen qëllimet për të cilat do të funksionojë Agjencia në punën e saj. Ekzistojnë dy lloje të qëllimeve organizative, të cilat pritet të çojnë në një rritje të efikasitetit dhe efektivitetit të punës së saj, dhe rregullatore, të cilat pritet të përmirësojnë disa aspekte të industrisë së medias. Pjesë përbërëse e Planit Strategjik është edhe Plani i Veprimit, në të cilin për çdo qëllim strategjik, krahas aktiviteteve që do të ndërmerren, përcaktohen edhe treguesit, si dhe periudha kur planifikohen të realizohen aktivitetet. Vitin e kaluar, Agjencia ka iniciuar zhvillimin e Kodit të Sjelljes në procesin online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve, i cili përfshin sjelljen e partive politike, kandidatëve të tyre dhe kandidatëve të pavarur në hapësirën online, gjatë zgjedhjeve dhe referendumeve, si dhe ka koordinuar nënshkrimin e Memorandumit për bashkëpunim me të cilin u krijua trupi koordinues për monitorimin e përmbushjes së parimeve dhe standardeve të përcaktuara në Kodeks. Vitin e kaluar janë kryer mbi 470 mbikëqyrje tek transmetuesit, operatorët, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë dhe mbi botuesit e medias së shkruar. Për shkeljet e konstatuara Agjencia ka shqiptuar gjithsej 82 masa . Vitin e kaluar, Agjencia ishte veçanërisht aktive në fushën e edukimit mediatik. Në tetor 2023 nën moton “Gishti i shpejtë sjell lajme të rreme” u organizuan “Ditët e edukimit mediatik 2023”, në kuadër të të cilave u mbajtën një numër i madh eventesh, konferencash, punëtorish, debatesh. Sipas ndryshimeve të LSHMAAV vitin e kaluar, Agjencia i vazhdoi lejet edhe për tre vite të tjera për gjithsej 90

televizione dhe radio, afati i vlefshmërisë së të cilave skadonte më 31 dhjetor 2024. Gjithashtu ka dhënë tre leja të reja, njëra për transmetim në radio dhe dy për transmetim televiziv. Janë bërë më shumë analiza dhe studime, Analiza e tregut 2022, Struktura e të punësuarve në industrinë mediatike audiovizuale në 2022, Pronësia e mediave 2023, tre studime për përcaktimin e justifikimi për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes. Shpjegoi se bëhet fjalë për draft version dhe në seancën e radhës Këshilli duhet të miratojë raportin përfundimtar dhe nëse ka vërejtje dhe çështje që nuk janë përmendur në Raport ndërsa anëtarët e Këshillit i konsiderojnë se janë të rëndësishme dhe duhet të jenë të përfshira në raport, ai sugjeroj që të dorëzohen me shkrim dhe nëse ka arsyetim të futet në versionin përfundimtar.

Z. Petrushevski tha se do të theksojë dy gjëra për draft dokumentin. Shënimi i parë ka të bëjë me propozimin e dorëzuar nga drejtori për miratimin e Draft-raportit. Gjegjësisht, në materiale, në propozim shkruhet “Këshilli të miratojë Draft-raportin...”, por me ndryshimet e fundit të LSHMAAV, Kryetari i Këshillit e nënshkruan Raportin, që do të thotë se Këshilli duhet ta sjellë dhe jo ta miratojë. Ai sugjeroi që të korrigohet sepse kështu dhe Këshilli do të votojë. Propozimi i dytë ka të bëjë me Raportin për punët materiale financiare të Agjencisë, ku saktë shënohet informacioni për pagesat më të vogla nga mjetet buxhetore të ofruara për ASHMA. Ai mendon se është mirë që këtë ta kemi edhe në hyrje. Deputetët dhe në përgjithësi të gjithë ata që janë të interesuar zakonisht lexojnë vetëm hyrjen. Për këtë ai propozoi si sugjerim drejtorit dhe shërbimit që të shtohet një fjalë e shkurtër në hyrje, një sublimim i asaj që shkruhet për pagesat e vogla. Para së gjithash, sepse para deputetëve lexohet vetëm hyrja kur drejtori ose ai si kryetar i Këshillit do të jenë në Kuvend për të sqaruar Raportin. Përveç kësaj, ky raport supozoi se do të shqyrtohet nga përbërja e re e parlamentit dhe ndoshta nga qeveria e ardhshme, dhe është mirë t'u tregohet se si nuk duhet punuar, duhet të paguajnë paratë nga buxheti siç është shkruar në Ligj. Për pjesën tjetër të përmbajtjes, ai tha se për momentin nuk ka shënime të tjera, por do ta lexojë edhe një herë.

Z. Ajdini tha se e kishte shqyrtuar Draftin-raportin vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023. Ai përfshin të gjitha aktivitetet e Agjencisë që i kishte realizuar në vitin e kaluar. Ai ka shpjeguar se edhe anëtarët e Këshillit kanë pasur pjesëmarrje aktive në pjesë të madhe të aktiviteteve, ndërsa në ndërkohë janë informuar rregullisht përmes raporteve tremujore. U deklarua se Draft raporti i propozuar si në formë ashtu edhe në përmbajtje, duke filluar nga hyrja, përmbajtja dhe shtojcat e raportit, nuk ka kundërshtime dhe se do ta mbështesë. Në fund ai përgëzoi Shërbimin Profesional në krye me Drejtorin për përgatitjen e raportit në mënyrë profesionale.

Z. Fidanovski deklaroi se do të mbështesë draft raportin vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023. Sipas tij, ai është i kompletuar, i punuar profesionalisht dhe tregon në detaje se çfarë ka bërë Agjencia vitin e kaluar. Drejtori Trajçevski në përgjithësi i radhiti të gjitha punët ku ka marrë pjesë dhe ka përfunduar Agjencia përveç detyrimeve të rregullta ligjore që ka. Raporti tregon se puna voluminoze është përfunduar me sukses, profesionalisht dhe me përgjegjësi. Në lidhje me propozimin e z. Petrushevski për financim, ai pajtohet se ndoshta si sublimim mund t'i shtohet një fjali hyrjes për mënyrën e financimit, përkatësisht për pjesën problematike të financimit që ka Agjencia.

Z. Trajçev tha se do ta mbështesë Raportin, i cili është voluminoz dhe i detajuar për atë që ka bërë Agjencia, dhe pjesë të atij roli aktiv në funksionimin e përgjithshëm e ka dhe Këshilli. Ai tha se veçanërisht do ta mirëpresë bashkëpunimin ndërkombëtar që ka pasur Agjencia, sepse është e rrallë që ndonjë institucion në vend të ketë një qasje kaq të hapur ku të ketë rol proaktiv në shumë zhvillime ndërkombëtare dhe bashkëpunim me institucionet tjera,

veçanërisht në pjesë e BE-së ku vendi ynë përpiqet të bëhet anëtare. Raporti është përpunuar në detaje, përshkruan të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur dhe të përmbledhur në raportin tremujor në një raport përfundimtar që pasqyron punën e përgjithshme të Agjencisë. Ai deklaroi se do ta mbështë plotësisht.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft-raportin vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, me tekstin e propozuar.

Pika 4

Z.Trajçevski shpjegoi Draft-Udhëzimin për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024. Ai shpjegoi se teksti i Draft-udhëzimit është në përputhje me disa institucione të tjera që janë të përfshira në mënyrë aktive në procesin zgjedhor, si Komisioni Shtetëror Zgjedhor, Enti Shtetëror për Revizion dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Informoi se Agjencia ka mbajtur dy takime me përfaqësues të institucioneve në fjalë, të cilët kanë marrë pjesë me komente dhe sugjerime që janë inkorporuar në këtë draft udhëzues. Ai tha para se të kalojë në elementet kryesore të udhëzimit, sepse tani do të mbahen dy cikle zgjedhore, parlamentare dhe presidenciale dhe kandidatët, gjegjësisht listat për zgjedhjet parlamentare, ende nuk janë konfirmuar nga KSHZ-ja, pas përcaktimit të listave nga KSHZ-ja, duhet të mbahet seancë dhe të plotësohet ky Udhëzim në të cilin do të përcaktohen rregullat për reklamimin politik me pagesë të partive politike në procesin zgjedhor për zgjedhjet parlamentare. Pas përfundimit të rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale dhe kur të dihet se cilët dy kandidatë do të shkojnë në rrethin e dytë, do të duhet të bëhen sërish ndryshime në këtë udhëzim për të përcaktuar kohën e pjesëmarrësve në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale. Në pikën 3 thuhet se si ndahen 9 minuta e gjysmë RPP për zgjedhjet parlamentare, pra cili nga pjesëmarrësit cilën kohë nga grupi mund të shfrytëzojë. Në Pikën 8 është përcaktuar gjatë gjithë fushatës zgjedhore se sa minuta do të mund të përdorin pjesëmarrësit në dy proceset zgjedhore për RPP. Në vendin tonë është hera e parë që të mbahen zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në këtë format, pra në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale të mbahen zgjedhje parlamentare. Në vitin 2014 ka pasur zgjedhje parlamentare dhe presidenciale në të njëjtën kohë, por më pas në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale janë mbajtur zgjedhje parlamentare, nuk ka pasur një mbivendosje të tillë të fushatave për të dy llojet e zgjedhjeve. Aspekti më i rëndësishëm dhe më i kushtueshëm i takimeve ishte përcaktimi i qëndrimeve për heshtjen zgjedhore. Duke qenë se zgjedhjet, rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale, do të mbahen të mërkurën, më 24 prill dhe do të ketë heshtje për zgjedhjet presidenciale, Udhëzuesi sugjeron që gjatë heshtjes për zgjedhjet presidenciale, duhet të vazhdojë fushata për zgjedhjet parlamentare, në mënyrë që pjesëmarrësit në listat e konfirmuara për zgjedhjet parlamentare të shfrytëzojnë RPP në përputhje me kodin zgjedhor prej 9 minuta e gjysmë dhe mediat më 23 prill dhe 24 prill deri në orën 19:00 të mos raportojnë për aktivitetet e fushatës për zgjedhjet parlamentare në edicionet ditore të lajmeve, dhe për të gjitha ato aktivitete më 23 dhe 24 prill të mund të raportohet pas orës 19:00 të datës 24 prill. Informon se draft-udhëzimi do t'u dërgohen që sot partive politike, institucioneve shtetërore që tashmë ka përmendur dhe mediave për të dhënë sugjerimet e mundshme dhe javën e ardhshme më 26 mars, pas përfundimit të 5 ditëve të diskutimit publik. Këshilli do të duhet të marrë një version përfundimtar të këtij Udhëzuesi për t'u dhënë kandidatëve një javë kohë për të lidhur marrëveshje mes tyre me partitë politike dhe me mediat në mënyrë që të mund të fillojnë në datë 4 prill kohë e planifikuar për RPP.

Z. Petrushevski tha se duhet të jenë fleksibël. Ata biseduan me drejtorin për orarin, pse 5 ditë diskutim publik, a mund të jetë më shumë se kaq, por ai i shpjegoi se është në interes të transmetuesve dhe të kandidatëve dhe pajtohet që Udhëzimet duhet të jenë miratuar sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që pas kësaj ata të lidhin kontrata për planet e tyre se si do të funksionojnë. Natyrisht, që kandidatët për zgjedhjet parlamentare sipas afateve mund më së voni të zbulohen më 3 ose 4 prill, ndaj duhet të jenë fleksibël dhe hap pas hapi t'i zgjidhin punët hap pas hapi, pra udhëzimet që do të miratohen në vijim do të ndryshohet dy here në javë. Lidhur me draftin duhet parë se çfarë komentesh do të dalin nga subjektet e interesuara. Ai tha se e ka shqyrtuar në detaje dhe vetëm në një vend është ngatërruar. Është shumë e rëndësishme të specifikohet se cilit nen të Kodit Zgjedhor i referohet udhëzimit. Në pjesën më të madhe, 90%, Udhëzimi është pasqyrim i Kodit Zgjedhor, siç është shkruar aty, ashtu është në të dhe është i shkruar kudo përveç Pikës 13, ku nuk tregohet se cilit nen i referohet. Ai propozoi verzion përfundimtar, në Pikën 13 para fjalës “për” të shtohet “në përputhje me 76 paragrafin (2) të Kodit Zgjedhor...” dhe më pas të vazhdonte fjalia ashtu siç është. Ai deklaroi se tani do ta mbështeste këtë version, por për versionin përfundimtar i sugjeroi drejtorit dhe shërbimit që ta inkorporojnë sepse kjo është e qartë për dikë që e njeh Kodin Zgjedhor, por dikush që nuk e njeh mund të ngatërrohet. Pas diskutimit publik, ai pret që partitë politike ta pranojnë, nëse ka kundërshtime do të shqyrtohen, nëse janë të aesyeshme do të korrigjohen.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft-Udhëzimin për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-udhëzimin e mësipërm për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024, ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë në afat prej 5 ditësh në faqen e Agjencisë në mënyrë që të siguron diskutim publik dhe t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore, mr.Emilija Janevska, shpjegoi Raportin e Parë nga monitorimi i periudhës parazgjedhore - nga 15 shkurti deri më 7 mars 2024. Sipas detyrimit të Kodit Zgjedhor, Agjencia ka nisur monitorimin e pasqyrimin mediatik zgjedhor nga data 15 shkurt, një ditë pas shpalljes së dy proceseve zgjedhore, dhe ky është raporti i parë për parazgjedhjet e para nga 15 shkurti deri më 7 mars 2024. Ai shpjegoi se si shembull të monitorimit kanë hyrë dy programet televizive të shërbimit publik të transmetimit RTM1 dhe RTM2 - program në gjuhën shqipe, TV Alsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel, TV Telma, TV 21-M dhe TV 24 Vesti. Kriteret e përzgjedhjes për këto media në kampion ishin që të kenë një shtrirje më të lartë ditore prej 2.5 përqind - e konfirmuar nga hulumtimi i bërë nga Market Vision, për periudhën prill-qershor 2023, dhe për transmetuesit e tjerë do të procedohen sipas peticioneve. Sipas “Metodologjisë për monitorimin e paraqitjes mediatike zgjedhore përmes shërbimeve programore televizive dhe radiotevizive gjatë proceseve zgjedhore”, në këtë periudhë para fillimit të fushatës zgjedhore, Agjencia është e fokusuar në programin në total të këtyre transmetuesve, por mbi të gjitha në edicionet qendrore të Lajmeve/TV Dnevnik dhe emisionet speciale të lajmeve që kanë të bëjnë me temat parazgjedhore dhe zhvillimet aktuale sociale dhe politike të brendshme. Nga fragmentet e

edicioneve qendrore të lajmeve, analizohen të gjitha ngjarjet e brendshme dhe nuk analizohen fragmente nga sporti dhe bota. Sipas dispozitave ligjore, fokusi në këtë periudhë parazgjedhore është mbi të gjitha respektimi i parimeve gazetareske dhe ndalimeve të veçanta nga LSHMAAV dhe disa dispozitave ligjore nga Kodi Zgjedhor, të cilat i referohen kësaj periudhe, nuk janë shumë, ato janë renditur në shënimet metodologjike në fillim të raportit. Lidhur me gjetjet kryesore për këtë periudhë, ai shpjegoi se mund të thuhet se kontributet informative gazetareske, të kontekstualizuara apo të përcjella si premtime parazgjedhore partiake, dhe janë theksuar shumë shpesh fragmentet kritike (raporte me koment/recension) elaboruar më pas përmes intervistave dhe debateve për pasojat ekzistuese, të vazhdueshme socio-politike të politikave të menduara jo mjaftueshëm dhe të keqmenaxhuara të pjesëve të mëparshme dhe të caktuara strukturore të përbërjes së qeverisë kalimtare. Në këtë pjesë parazgjedhore u shfaqën tri tema dominuese, si zhgënjimi individual dhe social nga labirintet administrative për zëvendësimin e dokumenteve të identifikimit personal, më pas përgjegjësia për neglizhencë sistematike ndaj pacientëve me sëmundje të rralla dhe/ose të rënda, si dhe statistikave shqetësuese për qytetarët e pavaksinuar nga të ashtuquajturat “Kolla e mirë” dhe tema e tretë ishte retorika fyese dhe kultura politike në komunikimin mes (ish) funksionarëve të funksioneve publike dhe punonjësve të medias, e ndjekur nga reagimet e mëpasshme, si nga redaksitë individuale, ashtu edhe nga shoqatat e gazetarëve. Pa përjashtim, të gjitha redaksitë informative, secila me qasjen e vet gazetareske/editoriale, shfaqën interes dominues për këto tre bërthama kryesore tematike. Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe janë regjistruar fragmente për disa të ashtuquajtur “pseudongjarje”, ngjarje që organizohen në parazgjedhje nga bartës të posteve të pushtetit në bashkëpunim me partitë politike ose veçmas, dhe qëllimi i shtojcave është vetëpromovimi, megjithatë mund të thuhet se edhe pse ka ende shkallë të ndryshme të pjekurisë kritike gazetareske në qasjen ndaj këtyre ngjarjeve, megjithatë situata është shumë e ndryshme nga proceset e mëparshme zgjedhore, mediat realisht tregojnë më shumë ndërgjegjësim për ngjarje të tilla. Shtojcat që lidheshin drejtpërdrejt me proceset zgjedhore u fokusuan në disa tema si mbledhja e nënshkrimeve për kandidatët për president, parashikimet e ekspertëve dhe partive për rezultatin e procesit zgjedhor, shumë kohë iu kushtua ndarjes në parti. - Aleanca për shqiptarët, shtojca për joparimitetin e veprimtarive partiake/qeveritare për një fushatë të vazhdueshme, duke deroguar kështu ndalesat e Kodit Zgjedhor për këtë çështje (vërejtje në tabelat e partive që promovojnë sukseset e partisë nga mandati i kaluar; përdorimi i fondeve shtetërore për qëllime private/partiake), dhe informacione për aktivitetet organizative rreth procesit zgjedhor, të ndërmarra nga Ministria e Punëve të Brendshme, KSHZ-ja, DKCK dhe ASHMA. Raporti ofron një pasqyrë të përfaqësimit të subjekteve në lajmet e të gjitha këtyre mediave të analizuara për ngjarjet e brendshme dhe gjithashtu ofron një pasqyrë të të gjitha intervistave dhe debateve të transmetuara që u kushtohen plotësisht ose pjesërisht çështjeve që lidhen me zgjedhjet. Është e rëndësishme të theksohet se përveç shërbimit të transmetimit publik të shërbimit të parë programor televiziv dhe TV 24, asnjë prej këtyre mediave nuk ofroi akses në informacionin për zgjedhjet, i cili është një detyrim ligjor nga Kodi Zgjedhor dhe ai detyrim ligjor me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor u plotësua dhe saktësua dhe tashmë do t'i referohen shërbimit publik dhe televizioneve kombëtare që do të transmetojnë RPP gjatë zgjedhjeve. Në këtë periudhë parazgjedhore të raportuar nuk vlerësohet bilanci në mënyrën e raportimit të mediave, por nga të dhënat tashmë shihet se si do të orientohen mediat gjatë fushatës zgjedhore. Meqenëse ka pasur përvoja nga proceset e mëparshme zgjedhore, disa nga mediat janë të fokusuar në dy partitë politike më të mëdha, dhe ka media që i japin shumë kohë njërit prej pjesëmarrësve në zgjedhje. Shpreson se Raporti do të jetë i dobishëm për transmetuesit që të shohin përmes numrave se si është

pozicionuar aktualisht secili prej tyre dhe do t'i ndihmojë të përmbushin detyrimin e tyre për të raportuar bilancin gjatë fushatës.

Z. Petrushevski, në lidhje me ndryshimet e reja në Kodin Zgjedhor për mediat ka siguruar qasje në informatat për personat me aftësi të kufizuara në lidhje me zgjedhjet, pyeti nëse ka dispozita penale (ndëshkuese) nëse nuk transmetojnë në atë mënyrë apo është vetëm deklaruar se duhet ta bëjnë këtë?

Udhëheqësja Janevska shpjegoi se për këtë do të duhet të diskutojnë më tej me kolegët e tyre nga Sektori për Çështje Juridike, sepse ndryshimi është bërë në nenin 75, i cili përcakton parimet e përgjithshme se duhet të raportojnë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme gjatë procesit zgjedhor dhe pyetja do të jetë nëse do të mund t'i referohemi dispozitës penale për këtë nen sepse brenda dispozitave penale janë të përcaktuara me paragrafë. Konkretisht për paragrafët e shtuar rishtazi nuk ka një dispozitë të veçantië penale, megjithatë, në paragrafin e parë të nenit 75, ku shprehet kërkesa për mënyrën e raportimit, në paragrafin e parë përmban që ato dhe ato media duhet të raportojnë gjithashtu për mënyrën dhe format e aksesueshëme për personat me aftësi të kufizuara.

Pika 6

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**